

RRETH MISSIONIT TE ACER

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike kërkon të promovojë reformën ekonomike në Shqipëri duke ndërmarrë studime dhe kërkime të pavarura mbi gjendjen e ekonomisë dhe duke kontribuar në krijimin e një kornize të përshtatshme institucionale pro-reformave të ekonomisë së tregut; duke inkurajuar debatin publik; dhe duke advokuar në politikat publike dhe vendim-marrësit e vendit.

Filozofia Jonë në Zbatimin e Projektit:

- Uji na bashkon;
- Uji ofron mundësi për të shtuar vendet e punës;
- Uji na mban të sigurtë dhe të shëndetshëm, dhe
- Uji ruan mjedisin tonë dhe komunitetin ku jetojmë.

Roli i shoqërisë civile për një mjedi të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm

- OJF-të kontribuojnë për një kuptim më të mirë të lidhjes midis shkencës dhe shoqërisë, e cila është ajo që siguron mjedisin e mundshëm dhe fuqinë krijuese për të adresuar sfidat komplekse me të cilat përballlet shoqëria në kohën e sotme.
- OJF-të luajnë rol kryesor në një proces që promovon zhvillimin dhe menaxhimin e koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve të lidhura me të, në mënyrë që të maksimizojë rezultatet në mirëqenien ekonomike dhe sociale në mënyrë të drejtë pa cenuar qëndrueshmërinë e eko-sistemeve vitale;
- Pjesëmarrja aktive e OJF-ve në nivel lokal, kombëtar e ndër-kufitar në të gjitha fazat e projekteve të lidhura me ruajtjen e mjedisit, kontribuon jo vetëm në rritjen e transparencës dhe vizibilitetit, por gjithashtu edhe në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë në tërësi.

BASHKËPUNIMI NDËR-KUFITAR (CBC) Shqipëri-Kosovë

Projekti “Për Ujë të Pastër në Gjakovë dhe Kukës” zbatohet nga një konsorcium i organizatave jo-qeveritare:

- SHE-ERA (partneri drejtues në Kosovë)
- ACER (partneri lokal në Shqipëri)

dhe njësitë e qeverisjes vendore:

- Komuna Gjakovë (Kosovë)
- Bashkia Kukës (Shqipëri)

Projekti ka nisur zbatimin nga Janari 2020 dhe zgjat 3 (tre) vite, deri në Dhjetor 2022.

Partneri kryesor



Partner në Shqipëri



Perfitues:



Komuna
Gjakovë



Bashkia
Kukës

Organizata partnere të shoqërisë civile të Kukësit:

- CYP - Qendra për Progres Rinor, Kukës www.cyp.al
- Ekologët për Rajonin Kukës
- Federata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Kukës
- Federate e Fermerëve, Kukës
- Këshilli Rinor Rajonal Kukës
- Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, Kukës
- QIZHDK - Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik, Kukës http://ecso-hub.albania.rec.org/detaje_te_organizates/93
- Shoqata "ALPIN" – Tropojë www.shoqata-alpin.al
- Shoqata "Biznesi për Biznesin", Kukës
- Shoqata Integrimi Tropojë
- Shoqata Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit, <http://mbrojtjamjedisit.weebly.com/>
- Shoqata për Kulturë Demokratike, Kukës



CLEAN WATER
PROJECT

Projekti për Ujë të Pastër në Gjakovë dhe Kukës

Bashkëpunimi Ndër-kufitar (CBC) Shqipëri-Kosovë

Uji i pastër është një e drejtë e njeriut. Ky është një nga besimet thelbësore të ACER dhe baza për përfshirjen në këtë projekt. Uji ka fuqinë për të sjellë ndryshime në të gjitha nivelet e shoqërisë, nga individi në transformimin e strukturave dhe të vlerave shoqërore. Ne duam që komuniteti i shoqërisë civile të Kukësit të jetë pjesë e këtij ndryshimi, ta drejtojë atë me qëllim që të përfitojnë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur. Të gjithë duhet të jenë në gjendje të gëzojnë akses të qëndrueshëm në ujë të pastër.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian
nëpërmjet Programit IPA

RRETH PROJEKTIT

Projekti për Ujë të Pastër në Gjakovë dhe Kukës është pjesë e programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës* për të përmirësuar politikën dhe praktikën e mbrojtjes dhe menaxhimit të ujit përmes përmirësimit të standardeve për menaxhimin e ujërave të zeza. Dizajni i përgjithshëm i projektit synon "forcimin e marrëdhënieve të dy vendeve fqinje nëpërmjet nxitjes së zhvillimit ekonomik ndaj mjedisit dhe përfshirjes sociale të rajoneve kufitare përmes promovimit të potencialit të tyre turistik dhe respektimit të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore".

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të stimulojë zhvillimin më të balancuar, përfshirës dhe të qëndrueshëm socio-ekonomik të zonës ndërkufitare. Thirrja paraprake e projektit mund të gjendet në linkun: https://eeas.europa.eu/delegations/albania/53887/node/53887_sq

Rezultatet kryesore të projektit përfshijnë ndërtimin kolektorit kryesor të ujërave të zeza në Kukës dhe impanti për trajtimin e tyre si dhe rregullimin e infrastrukturës së Lumit Llukac në Gjakovë. Nëpërmjet tyre pritet të rritet numri i popullsisë në aksesin e ujit të pijshëm, rritja e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve të reja, kontrolli i nivelit të ndotjes së ujit në zona urbane, rurale dhe industriale, menaxhim i qëndrueshëm i trajtimit të mbetjeve në zonat rurale dhe përgjatë brigjeve të lumenjve etj.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivi i përgjithshëm i veprimit është: "Përmirësimi i politikave, praktikave të mbrojtjes dhe menaxhimit të ujit përmes zbatimit të standardeve të përmirësuar dhe infrastrukturës së ujërave të ndotura." **Objektivat specifikë:**

- ❖ Promovimi i dialogut, bashkëpunim për politikën dhe ndërtimi i kapaciteteve përmes partneritetit midis qytetarëve, OSHC-ve dhe publikut.
- ❖ Zvogëlimi i përqindjes së popullsisë që nuk është e lidhur me sistemin e ujërave të zeza.
- ❖ Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore të ujit përmes përmirësimeve në infrastrukturën e lumit.
- ❖ Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të palëve të interesuara përkatëse përfshirë vendimmarrësit, kompanitë e shërbimeve, NVM-të, OSHC-të dhe qytetarët.

ANGAZHIMET E ACER SIPAS MoU

- Organizimin dhe pjesëmarrjen në nivel të lartë në takimet informuese me qytetarë rreth politikave, problemeve dhe programeve bashkiake rreth ujërave, në koordinim me SHE-ERA dhe Partnerin tjetër në Shqipëri - Bashkinë e Kukësit;
- Formimin e rrjeteve lokale me të rinjtë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak, për përfshirjen e tyre në projekte dhe nisma lokale në mbrojtje të ujërave;
- Promovimin e diskutimit të politikave të ujërave në Këshillin Bashkiak Kukës;
- Asistencë në hartimin e Dosjes së Tenderit me specifikimet teknike, ekspertizë dhe delegim të përfaqësuesve dhe ekspertëve në proces;
- Ndjekje e zbatimit të planit të detajuar të punëve infrastrukturorë (KUZ Kukës);
- Bashkëpunimi me Bashkinë e Kukësit në lidhje me sigurimin e lejeve të ndërtimit, pëlqimit ambiental, dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm për projektin e KUZ përpara se të shpallet tenderi përkatës;
- Organizimin e të rinjve në zbatimin e nismave lokale gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

REZULTATET E PRITSHME (Të përgjithshme)

- ❖ **Planet e Menaxhimit të Ujërave** të zhvilluara përkatësisht për Kukës dhe Gjakovë në përputhje me standardet e BE-së.
- ❖ **Nivelet e ndotjes së ujit** të matura më rregullisht dhe saktë.
- ❖ **Angazhimi i qytetarëve** në Planifikimin dhe Zbatimin e Politikave të Ujit
- ❖ **Zhvillimi i hartës së ndotësve të ngurtë** për lumenjtë e dy bashkive.
- ❖ Instalimi prej 500 m i **Impiantit të ujërave të zeza në Llukac**, Gjakovë.
- ❖ **Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të ujërave të zeza në Kukës**.
- ❖ Përmirësimi i 500 m të **Infrastrukturës së Lumit Llukac në Gjakovë**.
- ❖ **Rritja e kapaciteteve e zyrtarëve komunalë** në planifikimin dhe zbatimin e politikave të ujit.
- ❖ **Kapacitet e ndërmarrjeve të shërbimeve publike** (furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza) të rriten.
- ❖ **Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve** dhe aktivistëve të mjedisit.
- ❖ **Ndërgjegjësimi i NVM-ve dhe qytetarëve**.

AKTIVITETET E KRYERA nga ACER

Progresi i aktiviteteve në gjashtëmuorin e parë të projektit:

- ❖ ACER asistoi Bashkinë e Kukësit në hartimin e dosjes së tenderit gjatë procesit të prokurimit për tu menaxhuar sipas Rregullave dhe Udhëzimeve të PRAG.
- ❖ Në kuadër të ngritjes së Bordeve multi-sektoriale rajonale të Ujit, ACER hartoi një listë jo-shtruese të ligjeve/rrregulloreve që duhen referuar para dhe gjatë krijimit e tyre.
- ❖ Pjesëmarrje në trajnimin e parë online me titull "Ngritja e sistemit të monitorimit dhe mbledhja e të dhënave për raportimin në sistemin rajonal të monitorimit", më 26 Qershor, 2020.
- ❖ Pjesëmarrje në trajnimin dy-ditor online me fokus procedurat e shpalljes së njoftimit të kontratës sipas granteve të CBC-ës, 02-03 Korrik, 2020
- ❖ Rishikim i dokumenteve të disponueshme mbi listën e OSHC-ve që operojnë në Kukës dhe kontaktimi i tyre për bashkëpunim në vijim nëpërmjet emailit dhe telefonit.

AKTIVITETET NË VAZHDIM të ACER

- ❖ Monitorimi, këshillimi gjatë procedurave të prokurimit nga Bashkia Kukes për Mbledhësin Kryesor të Ujërave të Zeza dhe plani i trajtimit të ujërave të ndotura dhe asistimi për çdo pyetje që mund të lindë.
- ❖ Ngritja e rrjetit të bashkëpunimit me OSHC-ët që operojnë në rajonin e Kukësit në fushën e ndotjes së ujit dhe çështjeve mjedisore për krijimin e urave të komunikimit midis nesh.
- ❖ Një takim online është parashikuar me përfaqësues të OSHC-ëve për prezantim të projektit dhe marrja e komenteve/opinioneve lidhur me ndotjen e ujit dhe më tepër, në rajonin e Kukësit.

STAFI I PROJEKTIT:

Zef PREÇI, Asistent Kërkimor
acertirana@gmail.com
Tel: +355 68 202 0344

Amena LOSHA,
Menaxher Financiar
researchassistant.al@gmail.com
Tel: +355 68 201 1863

Blerina DORACAJ,
Eksperte për prokurimet
blerina.doracaj@gmail.com
Tel: +355 69 401 0135